



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 28 tetor 2022, në mbledhjen e VIII-të (tetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10;15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Florent Hasani; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin Nënkrjetarja e Komunës znj.Marigona Lahu, drejtorët e Drejtorive, dhe atë; (Antoneta Ejupi-Drejtorja e Administratës DA; Fatlum Osmani-Drejtorja e Buxhetit dhe Financave DBF; Adelinë Stublla-Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale DSHMS; Bahri Selimi-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit DSHPMSh)

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit, ndër të tjera theksoi, para se të fillojmë me rendin e ditës paraprakisht konstatojmë kuorumin, për momentin mungon vetëm z.Qendrim Softolli dhe znj.Adelina Stublla që ka kaluar në pozitën e drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe natyrisht nuk mund të jetë më në Kuvend dhe trupa të Kuvendit. Thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje e keni marrë me kohë, por para se të fillojmë me rendin e ditës ju njoftoj se këtu prezent është edhe znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës e cila ka kërkuar fjalën rreth një propozimi shtesë në rend të ditës.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, propozimi im të cilin po e prezantoj ka të bëjë me përfshirje në kuadër të rendit të ditës plotësim ndryshimin e vendimit të vitit 2020 ku të gjithë e dimë që Komuna e Podujevës në vitin 2020 ka filluar procesin e binjakëzimit me Qytetin Ames në Iowa të SHBA-ve, në bazë të vendimit të Kuvendit si person i autorizuar që t'i zhvilloj negociatat për binjakëzim ka qenë ish Nënkrjetari i Komunës z.Nexhmi Rudari dhe në bazë të konsultimeve me Zyrën Ligjore dhe MAPL-në, kërkohet që të bëhet ndërrimi i emrit të personit të autorizuar, pasi që kemi ndërrim të pushtetit tani person i autorizuar në vend të z.Nexhmi Rudari të jetë z.Shpejtim Bulliqi Kryetari i Komunës, si përfaqësues i Komunës së Podujevës.

z.Naim Çunaku, theksoi, e dini që zhvillimet e fundit kanë ngritur disa shqetësime dhe kemi disa informacione që pas lëshimit të seancës nga Grupi i këshilltarëve të LDK-së dhe të tjerëve, rreth kompensimit të mëditjeve është nënshkruar një listë nga Kryesuesi i Kuvendit ku janë të përfshirur ata që e lëshuan seancën, gjegjësisht ata që nuk deshën të marrin pjesë në punimet e asaj seance dhe atë duke e paraqitur qëndrimin në foltore të Kuvendit që ne si Grup nuk do të marrim pjesë në këtë seancë me arsyetim se njëri prej pikave të tyre ne si Grup e konsiderojmë se ka shkelje ligjore dhe për atë jemi thirrur decidivisht në 3 nene të Ligjit për buxhet, dhe është prej të drejtave elementare demokratike që

njihet si formë e protestës edhe mos marrja pjesë në seancë. Gjithandej Kosovës në dy nivelet dhe për këtë përvojë demokratike mbi 22 vjeçare nuk është as hera e parë e asnjë grupimi të vetëm politik por të gjitha grupimet politike që janë në skenën politike të Kosovës e kanë manifestuar qoftë në Kuvendet Komunale apo në Kuvendin e Republikës së Kosovës këtë formë të protestës dhe kurrë asnjëherë nuk ka ardhë në pyetje sanksionimi, gjegjësisht pengimi në realizimin e të drejtës së tyre siç e përcakton ligji.

Kemi një situatë këtu të cilën pa bazë ligjore, të paktën ne e konsiderojmë pa bazë ligjore, se ai që e ka bërë mund të thotë se edhe unë jam ligji dhe janë vendimet e mia, mirëpo një dynja e din që më së paku Kryesuesi i Kuvendit të Komunë së Podujevës është ai që merr vendime dhe fjalët që kanë rrjedhë nëpër kafiteri dhe qytet, jo ka thënë NN personi jo andej jo kënde, këtë do ta sqarojmë kur të janë këtu prezent, mirëpo ne këtë e konsiderojmë shkelje ligjore dhe krejt kjo nuk ish dashur të kalojë. Nëse dikujt i vendosni sanksion të paktën duhet të jepet një vendim në bazë të cilit duhet të ceket arsyeja e atij sanksioni në mënyrë që pala të ketë të drejtën e saj ligjore për ankimim, ne as atë nuk e kemi, do të thotë se e gjithë kjo është jashtë çdo rrjedhe normale demokratike dhe institucionale.

Konsideroj se Kryesuesi i Kuvendit e ka për obligim që të na sqaroj paraprakisht se cila është e vërteta dhe çka ka të bëjë mos realizimi i pagesave të mëditjeve të këshilltarëve që e kanë lëshuar seancën, pasi që do ta dëgjojmë Kryesuesin e Kuvendit unë do të propozoj një pikë shtesë që të përfshihet në kuadër të rendit të ditës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, faleminderit i nderuari zotëri Çunaku, sa për sqarim Kryesuesi nuk ka marrë vendim por ka ardhë sugjerimi prej administratës dhe në bazë të nenit 8, mëditja iu paguhet vetëm atyre që marrin pjesë në punime të Kuvendit dhe një kopje të saj ua kam përcjellë, kjo ka ndodhë edhe ditë më parë në mbledhjen e jashtëzakonshme që është thirrur nga subjekti politik OBKD dhe në atë mbledhje në të njëjtën mënyrë ka vepruar edhe LVV-ja ku së bashku me Grupin e këshilltarëve të PDK-së e kanë lëshuar mbledhjen edhe ata nuk janë përfshirë në mëditje, mbledhja nuk ka vazhduar për shkakun e tyre por i njëjti rast është se nuk kanë marrë pjesë në punime. Ne i'u kemi adresuar Ministrisë me një kërkesë për sqarim dhe nga ana e tyre ende nuk kemi marrë kurrfarë sqarimi, në atë moment që ne do marrim përgjigje nga ndonjë institucion më i lartë ne do t'i përgjigjemi dhe në mënyrë retroaktive do i bëjmë pagesat, ne së bashku me listën e pagave e kemi adresuar edhe kërkesën përkatëse në Ministri se a duhet të paguhet ose jo mëditjet dhe ende ky vendim nuk është ekzekutuar, kështu që pa u ekzekutuar vendimi ne nuk mund të marrim vendim për këtë çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, faleminderit për këtë sqarim i nderuari Kryesues, ndoshta po i marr disa minuta më shumë dhe dua mundësisht durimin e juaj sepse po mundohem në mënyrë kronologjike të tregoj diçka, pas zgjedhjeve lokale dhe pas frymës së disa grupacioneve politike për zgjedhje të reja të asamblesë komunale në veçanti ju zotëri Kryesues unë dhe znj.Mrika Thaçi si dhe disa kolegë tjerë jemi munduar të gjejmë një rrugë tjetër të bashkëpunimit duke menduar se zgjedhjet e reja nuk i kontribuojnë demokracisë e as Kuvendit dhe se zgjedhjet e reja do të prodhonin një rezultat tjetër përfaqësues të njëjtë dhe secili që merret me politikë e ka ditë se deshëm ose jo rrugët e bashkëpunimit nuk duhet të mbyllen, jemi munduar që të japim kontributin tonë që t'i konstituojmë organet e Kuvendit, ai kontribut ka rezultuar me zgjedhjen e z.Hilmi Hoxha si Kryesues i Kuvendit. Unë kam qenë njëri ndër këshilltarët e parë që ta kam uruar pozitën e Kryesuesit të Kuvendit dhe jam deklaruar se nuk mundem që të votoj për shkak të vendimit partiak, mirëpo jam duke u munduar të gjejmë zgjidhje që asambleja komunale mos të shkojë në zgjedhje sepse ky proces nuk është demokratik dhe nëse e keni durimin të më dëgjoni ju lutem prisni sepse unë jam duke fol ngase ju i keni tejkaluar normat, andaj dua t'i shpjegoj radhazi dhe kjo që ti mua më jep tani shpjegim që kjo ka ardhë nga administrata, këto janë përralla për fëmijë, por jo në një Kuvend serioz t'ju drejtoresh kuvendarëve kështu, arsyeja pse, cili është ai neni 8 që e përmende këtu, çfarë shpjegimi thua për nenin 8, neni 8 i kujt, neni 8 çfarë, kush është administrata me marrë vendim ose kush je ti me marrë vendim.

Kuvendi është organ kolegjal, vendimet i merr Kuvendi, ti je ai që ke autoritet të nënshkruash diçka dhe ti e ke bërë diferencimin këtë dhe atë, e di që keni kërkuar sqarime edhe në MAPL, fundja nuk është administrata e as zyra ligjore që përcakton se a janë të ligjshme a të pa ligjshme vendimet e Kuvendit, për këtë vendos një instancë më e lartë sepse nuk mundet një instancë më e ulët të shpjegoj se a është një vendim i ligjshëm ose jo.

I nderuari Kryesues gjatë kësaj kohe jam munduar dhe disa herë kam ra në pozitë që dikush ka mundur edhe të më keqkuptoj, mirëpo qëllimi im ka qenë që ta kthej në normalitet këtë Kuvend, ato sjelljet tua për ta mbytur demokracinë dhe debatin për ato gafat e tua, që nuk them se LDK është grupi më i madh politik në Kuvend e ku ta di unë me ato thëniet tjera këto e ato, i kanë tejkaluar të gjitha masat, kjo çfarë ke bërë ti sot tregon shumë dhe kurrë s'kisha besuar që një miku tim mundem me ju drejtuar kështu, por dalloje mikun me Kryesuesin e Kuvendit.

Po i drejtohem një Kryesuesi të Kuvendit që për mua ka mbet pa dinjitet, pa integritet dhe pa identitet, pse po i them këto dhe po mundohem t'i arsyetoj, nuk mundesh t'i ndalosh dikujt mëditje pa i dhënë vendim se për cilën arsye janë ndal ato mëditje, për ta shpjeguar këtë tani nuk jeni duke e luajtur rolin e Kryesuesit po jeni duke u munduar ta luani rolin e sunduesit, dikush edhe duron por dikush nuk duron, nëse ky gjen këshilltar që i mbyllet goja me një subvencion apo bursë të cilat janë duke ndodh dhe mendon se të gjithë mund t'i fusësh në një thes e ke gabim, për mos me zgjatë më shumë debatin, unë propozoj që në këtë mbledhje të KPF-së si pikë e veçantë për mbledhjen e nesërme të Kuvendit të jetë trajtimi i mos pagesës, mos realizimit të mëditjeve.

Po të isha në vendin e juaj do të thosha edhe diçka më shumë e ajo pak më shumë është burrimi, është moral, por s'po e them sepse po e lë në një seancë tjetër që do e shohim rrugën tjetër. I nderuari Kryesues ju keni marrë pagë të dyfishtë në kundërshtim me ligjin për konflikt të interesit, kurse ua ndalon kolegëve tuaj mëditjen që u takon ligjërisht, ndërsa të përvetësosh vet në mënyrë të kundërligjshme është përtej "mashallahut" dhe po e përmbylli këtë.

Unë propozoj që nesër në mbledhjen e Kuvendit të hyjë si pikë e veçantë debati rreth mos realizimit të pagesave ndërsa ajo që më the se jo e kanë lëshuar këta ose ata mbledhjen e Kuvendit nuk është ashtu me një arsye. Unë kam dëgjuar dhe gjegjësisht më është thënë nga ti se pa u miratuar rendi i ditës..., por gjema ti një germë që e përcakton ligji kur konsiderohet një mbledhje e filluar dhe kur jo sepse këtë e keni borxh të na sqaroni deri sa thirreni në të, ma gjeni një bazë ligjore kur konsiderohet një mbledhje e filluar dhe kur konsiderohet e mbaruar.

Një mbledhje e filluar thua se nuk është bërë rendi i ditës kur vijne këshilltarët nënshkruhen në listë dalin flasin në foltore dhe e lëshojnë atë si vendim politik dhe të thuash se nuk ka filluar mbledhja, ku po i gjen këto sepse këto janë rrugë të gabuara i nderuari Kryesues dhe krejt në fund propozoj që si pikë e rendit të ditës të hyj edhe mos realizimi i pagesave gjegjësisht puna e Kryesuesit me menaxhimin e seancës.

Kryesues i Komitetit, theksoi, i nderuari këshilltar z.Naim Çunaku, ju gjithëherë thirreni në ligj por edhe ne thirremi në ligj, atëherë nëse do bëheshin pagesat për secilin që vjen ose nuk vjen atëherë s'do të kishim mëditje fare, i njëjti rast është si me LVV-në dhe PDK-në, këta e kanë lëshuar mbledhjen në fillim pa u miratuar rendi i ditës, edhe tani i njëjti rast është.

z.Naim Çunaku, theksoi, jam i interesuar të debatohem në Kuvend e jo këtu.

Kryesues i Komitetit, vazhdoi, në qoftë se një instancë më e lartë thotë se ne nuk kemi pasë të drejtë atëherë në mënyrë retroaktive do t'iu paguhet mëditja prej 125 € asamblistëve përkatës.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju lutem më jepni vendimin në bazë të cilit nuk është realizuar pagesa e mëditjes sepse unë dua të drejtën e ankesës, ti duhet të më pajisësh me një vendim ku jeni bazuar në ndaljen e pagesave të mëditjeve, kjo është njerëzore, demokratike, ligjore dhe gjithçka nuk funksionon kështu siç po mendon ti, po thirreni në ligj unë e kam një shkresë të cilën ma keni dhënë dhe kjo s'ka koment që keni bërë ju i nderuari zotëri Kryesues.

Zyra Ligjore juve i'u është përgjigjur, por ju nuk e keni marrë për bazë përgjigjen e Zyrës Ligjore kur ju ka përgjigjur se kjo është në kompetencën e juaj, ju thirreni në nenin 11.2 të Udhëzimit Administrativ për pagesën e stafit politik në komuna ku thuhet; anëtarët e kuvendeve komunale të përcaktuar sipas nenit 8 të këtij Udhëzimi Administrativ të cilët nuk marrin pjesë në seancat e mbajtura të Kuvendit të Komunës, kompensimi mujor i'u zvogëlohet për 125€, çka po thotë kjo dispozitë, po thotë të cilët nuk marrin pjesë, nuk po thotë ata të cilët e lëshojnë mbledhjen, ai që s'ka marrë pjesë në mbledhje do të thotë ai që s'ka marrë pjesë e në rastin konkret janë kolegët z.Arjant Topanica dhe z.Gazmend Islami të cilët nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, por jo edhe ata këshilltarë që marrin pjesë në mbledhje dhe dalin diskutojnë në foltore.

znj.Mrika Thaçi, theksoi, sinqerisht i kërkoj falje kolegut z.Naim Çunaku sepse disa herë i kam thënë të mos e merr fjalën, por definitivisht ky veprim që e keni bërë ju zotëri Kryesues është jo njerëzor, ka kohë që unë jam në skenën politike dhe sot nuk po flas si anëtare e KPF-së, por po flas tamam si kolege se prej vitit 2007 jam anëtare në këtë Kuvend dhe nuk e di se a ka ndodh ndonjë praktikë si kjo, për këtë presim sqarime nga ana juaj përse ka ndodhur kjo.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë jam anëtar i Kuvendit prej vitit 2000, në vitin 2000 një grupim politik nëse nuk gaboj ka qenë nga PDK-ja kur Kryetari i Komunës ka qenë edhe Kryetar i Kuvendit do të thotë, me dy kompetencat e tij dhe në një mospjesëmarrje sigurisht ju kujtohet zotëri Kryesues se një kohë kemi qenë së bashku dhe si shkak i asamblistëve që nuk kanë dashur të dhënë betimin pa flamur Kombëtar e që së paku 3 muaj ata asamblist nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, por nuk iu janë ndalë mëditjet edhe pse Kryetari i Komunës ka qenë edhe Kryetar i Kuvendit, këtë veprim që e keni marrë dhe dëshironi ta instaloni kjo është njëfarë forme që ta disiplinonjë dhe të marrim veprime jashtë institucionale, por kjo formë nuk vazhdon dhe nuk bënë kështu.

Kryesues i Komitetit, theksoi, unë mendoj se ka instanca më të larta, është Ministria e Financave dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që na kontrollojnë neve kështu që çdo vendim që na vjen nga ana e tyre ne do e përkrahim, në qoftë se na vjen nga Ministria përkatëse ndonjë konfirmim pozitiv lidhur me kërkesën time për mëditjet atëherë në mënyrë retroaktive bëhen pagesat dhe nuk kemi arsye të diskutonjë më shumë rreth kësaj çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, askush nuk ua jep të drejtën juve i nderuari Kryesues që ta vëni në diskutim një çështje për të cilën nuk keni bazë ligjore dhe për atë çështje të kërkonit interpretim ligjor, ju e keni dërguar një shkresë në MAPL pa bazë ligjore, na tregoni se në bazë të cilave dispozitave ligjore keni kërkuar interpretim ligjor kur keni marrë mendimin edhe të Zyrës Ligjore që këtë çështje nuk e përcakton rregullativa ligjore në fuqi dhe ju i keni dhënë vetit të drejtë tani se nuk ju ka pëlqyer kjo dhe tani po bëni interpretim. Çka ndodh me demokracinë i nderuari Kryesues kur lëshohet seanca, a e dini more sa lëshime të seancave ka në demokracinë e Republikës së Kosovës, është mjet demokratik lëshimi i seancës, nuk vazhdon kështu, e merr përgjegjësinë vetë vetiu i nderuari Kryesues se keni hyrë në një rrugë që keni me i shkaktuar probleme edhe sjelljes normale të këtij Kuvendi për të mos thënë edhe gjëra personale sepse nëse ti e ndal pagën time pa mbështetje ligjore atëherë keni problem personale me mua, nuk e ke atë të drejtë, (shikoje sa të doni në pasqyrë por nuk del Luan në pasqyrë nëse nuk je në anën e kundërt të saj).

Kryesues i Komitetit, theksoi, për mos me zgjatë më tepër debatin ne do të presim përgjigje, do të vijmë listat e pagave dhe shihet se a janë dalë pagat apo jo, ankoheni dhe e shohim se kush ka të drejtë, i nderuari këshilltar z.Naim Çunaku atëherë nëse kështu do të kishte ndodhur ne gjithëherë do vinim t'i lëshonim seancat dhe nuk do të mbaheshin mbledhjet e Kuvendit dhe nuk do të miratohej rendi i ditës dhe do t'i merrnim pagesat.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju lutem mos u ktheni te rendi i ditës sepse jeni duke më shkaktuar telashe, këtë ua thash edhe më parë, ma gjeni diku në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës që e rregullojnë punën e Kuvendeve Komunale se a është e rregulluar taksativisht se kur konsiderohet një mbledhje e filluar dhe kur e mbaruar, mos ju lutem, nuk është kështu, mos bëni lojëra fjalësh. Unë që në fillim ju kërkova falje, Ligji për vetëqeverisjen lokale në dy dispozita e përcakton se kur Kryetari bën bashkëpunim me Kuvendarët, në rastin e parë kur këshilltari do të duhet ta japë betimin por s'ka kuorum dhe e humb mandatin, këtë se kemi provuar dhe rasti i dytë është kur zgjedhet Kryesuesi i Kuvendit. Në të dy format po provohet funksionaliteti dhe jo funksionaliteti, gjegjësisht ndërtimi i institucioneve dhe ne e kemi dhënë kontributin tonë për ta tejkaluar këtë dhe ty zotëri Kryesues apo dikujt tjetër pas një kohe i vie në mendje dhe nëse është kjo e dikujt tjetër ashtu siç po thua nëpër kafiteri është mirë që këtë ta thoni edhe këtu, por e thoni nesër dhe të dihet se kush është adresa e kësaj çështje, por kjo nuk mund të kalojë kështu sepse përgjegjësia bie mbi ju zotëri Kryesues dhe mbi atë që jeni duke bashkëpunuar në këtë formë.

Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket listave të pagave ajo është punë e Zyrës së Personelit dhe asnjëherë unë nuk jam përzier në ato lista sa i përket përfshirjes ose heqjes së ndokujt prej atyre listave.

z.Naim Çunaku, theksoi, listën e Zyrës së Personelit unë e përcjell, por ju lutem mos na bëni këso gjërash, përse jemi sot këtu.

Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse është ashtu atëherë s'ka pas nevojë të ketë mëditje, por është dashur të ketë vetëm pagë, prandaj për këtë arsye është mëditja për anëtarët që marrin pjesë në Kuvend.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, më falni a është në rregull zotëri Kryesues kur ushtruesit e detyrës së drejtorëve të Drejtorive i ka emëruar Kryetari i Komunës në muajin janar dhe po të njëjtit janë paguar në muajin shkurt si asamblistë, na thoni a është në rregull kjo ato pagesa janë bërë prej këtij Kuvendi, i keni listat nëse nuk është e vërtetë mund të hulumtoni.

Unë i kam të gjitha listat dhe nëse është emëruar në janar një ushtrues detyre që i bie të jetë drejtor i drejtorisë përkatëse dhe është paguar në muajin shkurt si asamblist a është në rregull kur është paguar në muajin janar si drejtor kur dihet se në të njëjtën kohë nuk mund t'i ushtroj dy funksione.

z.Naim Çunaku, theksoi, të paktën e kemi Kryesuesin e Kuvendit që i ka marrë 4 paga por nuk po hyjmë në këtë temë sepse nuk është temë kjo, por është diçka tjetër. Kryesuesi u mundua të na shpjegojë qysh paguhen mëditjet e asamblistëve, por këtë mos të ma shpjegojë mua sepse deri në vitin 2007 ka qenë vendimi i Kuvendit për shpërblimin e anëtarëve të Kuvendit, pastaj në vitin 2007 me një Udhëzim Administrativ të nxjerrë në kohën e qeverisjes së Kryeministrit z.Hashim Thaçi është bërë organizmi gjegjësisht pagesa uniforme në nivel të Republikës së Kosovës dhe që nga ajo kohë e deri më sot është e njëjta rregullativë ligjore në fuqi, për të mos përsëritur më shumë këtë, Kuvendet e Komunave janë të obliguar t'i mbajnë 10 seanca eventualisht 12 seanca maksimale të cilat paguhen, pagesa fikse është 100€, mëditja është 125€, mos na fusni në këto tema sepse të gjithë e dimë çka ka ndodh në seancën e kaluar.

Kryesues i Komitetit, theksoi, vazhdojmë me rendin e ditës, së pari e hedhim në votim propozimin e Nënkryetares së Komunës znj.Marigona Lahu, respektivisht propozimin e Kryetarit të Komunës, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 31 tetor 2022, ndryshim plotësimet e vendimeve që i referohen nismës dhe autorizimit për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me Qytetin Ames të shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, mbështetet kërkesa e Nënkryetares së Komunës, respektivisht propozimi i Kryetarit të Komunës, për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për mbledhjen e Kuvendit të Komunës caktuar të mbahet më 31 tetor 2022, ndryshim plotësimet e vendimeve që i referohen nismës dhe autorizimit për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar me Qytetin Ames të shtetit të IOWA në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi edhe një propozim, informatë që duhet të hyjë si pikë e rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme.

z.Naim Çunaku, theksoi, ju lutem zotëri Kryesues, kështu nuk mund të vazhdohet, së pari ishte propozimi i Nënkrjetares së Komunës znj.Marigona Lahu dhe jemi në rregull, kurse propozimi i dytë ishte propozimi im.

Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë e vëmë në votim propozimin e këshilltarit z.Naim Çunaku për përfshirje në rend të ditës.

Nga tetë (8) anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota për, të tjerët nuk votuan, Kryesuesi Konstaton se mbështetet propozimi i z.Naim Çunaku.

Nga zyrtari përkatës i Zyrës Ligjore (që mban procesverbalin) u kërkua që të specifikohet qartë formulimi i propozimit të pikës shtesë të rendit të ditës të propozuar nga këshilltari z.Naim Çunaku, ngase gjatë diskutimeve çështja në fjalë është përmendur dy apo më shumë herë në variante të ndryshme.

z.Naim Çunaku, theksoi, me insistimin e juaj mirëpo kjo të jetë hera e fundit, propozimi im konkret është ky, trajtimi i mos realizimit të pagesës të një pjese të kuvendarëve dhe udhëheqja e seancave nga Kryesuesi i Kuvendit, këtë e them se Kryesuesin e kam mik dhe sa herë të doni këtë propozim hedheni në votim se kam atë problem fare hiç.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, atëherë mos të debatojmë më shumë dhe pa humbur kohë e vë në votim propozimin e z.Naim Çunakut, për përfshirje në rend të ditës, respektivisht për mbledhjen e Kuvendit të Komunës çështja: trajtimi i mosrealizimit të pagesës së një pjese të kuvendarëve, gjegjësisht udhëheqja e seancave nga Kryesuesi i Kuvendit.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstaton se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, 2 vota Kundër, të tjerët nuk votuan, mbështetet kërkesa e z.Naim Çunakut, për përfshirje në rend të ditës, respektivisht për mbledhjen e Kuvendit të Komunës çështja: trajtimi i mosrealizimit të pagesës së një pjese të kuvendarëve, gjegjësisht udhëheqja e seancave nga Kryesuesi i Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, vazhdoi, jeni në dijeni se znj.Adelina Stublla është emëruar në pozitën e drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Podujevës dhe me këtë rast ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltares së Kuvendit të Komunës, pastaj nga ana e Komunës janë zhvilluar të gjitha procedurat për zëvendësimin e saj dhe ndërkohë më datë 25 tetor 2022, pasi që e kemi dërguar thirrjen dhe materialin e mbledhjes, kemi pranuar vendimin e KQZ-së që më datë 19 tetor 2022 znj.Lirika Maliqi është emëruar anëtare e Kuvendit të Komunës duke e zëvendësuar znj.Adelina Stublla.

Duke marrë për bazë dispozitat ligjore në fuqi anëtarja e emëruar duhet të jap betimin solemn në Kuvendin e Komunës, dhe në këtë rast betimi duhet të jepet në mbledhjen e radhës së Kuvendit andaj kërkohet nga ana e juaj që të përkrahet zëvendësimi në fjalë. Arsyeje pse kjo nuk është përfshirë në kuadër të rendit të ditës është për shkak se njoftimi ka ardhë me vonesë, pasi që e kemi caktuar rendin e ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, është mirë që propozimi i juaj të jetë si pikë e parë e rendit të ditës në mënyrë që dhënia e betimit solemn nga anëtarja e zëvendësuar e Kuvendit të bëhet në fillim të seancës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, propozoj që zëvendësimi i anëtares së cekur të bëhet para miratimit të rendit të ditës në mënyrë që në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, para se të fillohet me rendin e ditës të

bëhet Betimi solemn nga znj.Lirika Maliqi, pasi që KQZ e ka emëruar anëtare të Kuvendit të Komunës së Podujevës, duke zëvendësuar ish anëtares znj.Adelinë Stublla.

Pas Votimit, Kryesuesi konstatoi se njëzëri, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe dy (2) pikat shtesë të cekura më lartë, si dhe dhënia e Betimit solemn nga znj.Lirika Maliqi.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28.09.2022

Me 4 vota Për, nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, (të tjerët nuk votuan), pa vërejtje apo ndryshim plotësime, miratohet procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 28 shtator 2022, sipas materialit përkatës të dërguar.

2. Informatë nga Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë

Kryesuesi i KPF-së konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit, përkatësisht që Informatën në fjalë do ta paraqes Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë në mbledhjen e Kuvendit të Komunës ashtu siç paraparë me rendin e ditës..

3. Propozim Rregullorja për Taksa Tarifa dhe Gjoha Komunale

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj propozim Rregulloreje, theksoi, Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoha Komunale ka kaluar dhe është miratuar si draft rregullore në mbledhjet e kaluara të asamblesë komunale, tani janë bërë disa ndryshime për dallim nga draft rregulloren e kaluar që është aprovuar si draft. Komuna e Podujevës normalisht ka operuar me rregulloren për taksa tarifa dhe gjoha komunale, mirëpo është parë e arsyeshme që të bëhen disa ndryshime në këtë rregullore andaj propozoj që kjo propozim rregullore të kaloj në Kuvend për debat dhe miratim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush nga ju ka diçka për të shtuar urdhëroni nëse jo atëherë propozimin në fjalë e vë në votim sipas materialit përkatës.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

4. Raporti Financiar i Komunës për periudhën janar – shtator 2022

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF, duke paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj propozim Rregulloreje, theksoi, edhe raporti financiar është obligim ligjor që brenda muajit tetor duhet të bëhet raporti financiar dhe të prezantohet në Kuvendin Komunal për periudhën janar-shtator 2022, dhe propozoj që kjo pikë të kaloj për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush dëshiron ta merr fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës e vë në votim.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

5. Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Stacionit të Autobusëve në Qytetin e Podujevës

z.Bahri Selimi, drejtor i DSHPMSh, duke e paraqitur fjalën hyrëse rreth këtij propozim vendimi, theksoi, siç jeni pajisur me materialin për të cilin ne ju kemi njoftuar për caktimin e lokacionit për ndërtimin e stacionit të autobusëve në qytetin e Podujevës. Sa për informimin e Juaj ne kemi iniciuar procedurat për ndërtimin e stacionit të autobusëve në bashkëpunim me nivelin qendror, kështu që me material jeni të pajisur, diskutimin mund ta bëjmë edhe ditën e seancës por shpresoj që është një prej vendimeve të rëndësishme që duhet ta marrë Kuvendi, prandaj ju ftoj që edhe sot ta votoni këtë propozim vendim që të kaloj në Kuvend për mbledhjen e radhës.

z.Florent Hasani, theksoi, e përshëndesim vendimin e drejtorit dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratim.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse dikush dëshiron ta merr fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës e vë në votim.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

6. Propozim vendimet për:

- *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: “Ushton Lumi” në Popovë-Komuna e Podujevës, si Peizazh i Mbrojtur (arsyeshmëria profesionale e MMPHI – AMMK / IKMN)*
- *Mbrojtjen e Vlerës së Natyrës: “Trungu i Qarrit” (Quercus cerris) në Fshatin Lupç i Poshtëm-Komuna e Podujevës, si Monument i Natyrës (Elaborat i arsyeshmërisë profesionale -MMPHI – AMMK / IKMN)*

z.Naim Çunaku, pyeti se a ka ndonjë arsye përse mungon drejtori i Drejtorisë përkatëse, duke theksuar se, të gjithë në mbledhjen e kaluar jemi dakorduar që asnjë pikë e rendit të ditës të mos kaloj në qoftë se nuk është prezent drejtori i Drejtorisë përkatëse apo propozuesi i saj për të dhënë sqarimet dhe përgjigjet e nevojshme rreth atij propozimi..

z.Fatlum Osmani, drejtor i DBF-së, theksoi, ky është një propozim që pika e rendit të ditës të kalojë për diskutim dhe miratim në seancën e Kuvendit Komunal.

z.Naim Çunaku, theksoi, ligjërisht jemi në rregull por me fjalët që i kemi thënë në mbledhjen e kaluar nuk jemi në rregull, këtë e them se dikush lidhet për fjalë e dikush lidhet me “litar dikund”.

Kryesuesi i Komitetit, duke iu përgjigjur parafolësit theksoi, këtu biseda po lidhet për para më shumë, e gjithë biseda këtu po ndërlihet për mëditje.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, nuk është tema për para e as për mëditje këtu i nderuari Kryesues sepse kjo temë nuk ka të bëjë asgjë me atë që ju e cekët.

z.Naim Çunaku, duke i'u përgjigjur Kryesuesit, theksoi, po më detyron ta them sërish se ju jeni ai që i keni marrë 4 paga në mënyrë të kundërligjshme dhe tani po na flisni për paga mos i nderuari Kryesues.

Kryesuesi i Komitetit, duke i përgjigjur sërish parafolësit, theksoi, më vie keq por nuk është e vërtetë kjo që e thoni i nderuar.

z.Naim Çunaku, sërish përgjigje Kryesuesit, theksoi, e dini këtë punë sepse i keni dhënë ju disa deklarata dikund....

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, jeni ankuar dikund ju i nderuari këshilltar z.Naim Çunaku, dhe temën e mëditjeve e diskutuam rreth 20 minuta.

z.Naim Çunaku, theksoi, unë nuk dua ta gënjej vetën dhe askënd, është e vërtetë që më ka ardhë rëndë ajo fjalë por më rëndë se sa ajo është kjo forma që po tentoni disiplinimin në mënyrë kundërligjore.

Kryesuesi i Komitetit, duke i'u përgjigjur parafolësit, theksoi, nuk kemi të bëjmë asgjë me disiplinim, andaj pa humbur më shumë kohë e vë në votim propozim vendimin në fjalë sipas materialit përkatës.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 3 vota Për, (të tjerët nuk votuan), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimeve në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

7. Propozim vendimi për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dihet se Rregullorja përkatëse është miratuar dhe tani në këtë mbledhje kemi propozim vendimin për formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane në territorin e Komunës së Podujevës, andaj lidhur me këtë pikë të rendit të ditës fjalën ia kaloj drejtoreshës së Drejtorisë së Administratës.

znj.Antoneta Ejupi, drejtoreshë e DA, duke e paraqitur fjalën hyrëse rreth kësaj pike, theksoi, Rregullorja e Komunës për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Podujevës, konkretisht në nenin 3 përcakton formimin e komisionit për koordinimin e procesit të zgjedhjes së këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, andaj nga ana e juaj kërkoj që ky propozim të votohet në këtë mbledhje dhe në mbledhjen e radhës së Kuvendit duke përfshirë edhe anëtarët e komisionit që do të propozohen sigurisht në mbledhjen e Kuvendit .

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë propozimin në fjalë e vë në votim sipas materialit përkatës.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, ndërsa emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen dhe vendosen në mbledhjen e Kuvendit.

8. Propozim vendimi për formimin e komisionit ad-hoc për hartimin e draft Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, duke paraqitur këtë propozim, theksoi, paraprakisht për vitin e ardhshëm duhet të bëhet plani i punës së Kuvendit dhe të formohet një komision në përbërje prej anëtarëve të Kuvendit dhe nga anëtarë të Ekzekutivit të Komunës, kështu që 4 anëtar duhet të zgjidhen nga radhët e Kuvendit dhe 3 anëtar nga radhët e Ekzekutivit, prandaj nëse nuk dëshiron fjalën ndokush, e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit përkatës.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, ndërsa emrat e anëtarëve të komisionit të propozohen dhe vendosen në mbledhjen e Kuvendit.

9. Plotësim ndryshimi i përbërjes së Komitetit për Politikë dhe Financa (pas dhënies së dorëheqjes të anëtares së Komitetit, respektivisht anëtares së Kuvendit znj.Adelinë Stublla)

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, duke paraqitur këtë propozim, theksoi, pas dhënies së dorëheqjes së anëtares së Komitetit, respektivisht anëtares së Kuvendit znj.Adelinë Stublla tani duhet të zëvendësohet me anëtares e re të Kuvendit të cilën e potencuam më herët dhe duhet të plotësohet përbërja e KPF-së nga një anëtar nga radhët e LVV-së, pa humbur kohë më shumë e hedh këtë propozim vendim në votim sipas materialit përkatës.

Kryesuesi i KPF-së, konstatoi se nga 8 anëtarë sa ishin prezent në sallë, me 4 vota Për, të tjerët nuk votuan, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të propozim vendimit në fjalë sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes, ndërsa propozimi dhe vendosja për plotësimin e përbërjes së KPF-së të bëhet në mbledhjen e Kuvendit.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 11:05

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.prot.01-060/04-0091525/22
Podujevë,
28 tetor 2022**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**